



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 05.09.2016

Ref.: 783/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), nenin 126 dhe 136 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim të vendimit nr. 711/16 e datës 03.08.2016 e Kolegjit "ISPE", si e pa bazuar.

II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.641/16, datë 15.07.2016.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji "ISPE" ka parashtruar kërkesë (nr. 711/16, datë: 03.08.2016) për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (nr. 641/16, datë 15.07.2016). Përmes kësaj kërkesë, Kolegji ISPE ka kërkuar të rishqyrtohet mos akreditimi i programit MA Biznes dhe Menaxhment nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC).

KSHC ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit "ISPE" dhe ka vendosur të refuzojë kërkesën për rishqyrtim të datës 03.08.2016 dhe të lë në fuqi vendimin e KSHC-së të marrë më datë 15.07.2016.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) ka analizuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të dorëzuar nga Kolegji "ISPE" në lidhje me mos akreditimin e programit MA Biznes dhe Menaxhment. KSHC ka konstatuar se ky institucion nuk ka sjellë ndonjë dëshmi e cila do të mund të merrej parasysh për të ndryshuar vendimin e KSHC-së. KSHC konsideron se gjendja faktike në kohën e vlerësimit të Kolegjit ISPE është trajtuar me saktësi nga ekspertja ndërkombëtare e akreditimit dhe se argumentet e ekspertës për mos akreditimin e programit të studimit janë ofruar në Raportin Final të Ekspertëve të pranuar më datë 22 Qershor 2016.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit ISPE;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë